



# Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

## Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63  
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: [secretariat@nocalbania.org.al](mailto:secretariat@nocalbania.org.al) • <http://www.nocalbania.org.al>

### NJOFTIM PËR POZICION GAZETAR/E

*Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, themeluar në vitin 1958, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike, dhe që funksionon sipas statutit të saj. KOKSH është organizata e vetme që përfaqëson Lëvizjen Olimpik Shqiptare, parimet e së cilës janë të detyrueshme për tu zbatuar nga të gjithë anëtarët e saj.*

Në kuadër të Projektit **“Ekipet Sportive 2022”**, projekt i financuar nga Buxheti i Shtetit, KOKSH, fton kandidatët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e punës **“Gazetar/e”**.

Objektivi i përgjithshëm i Projektit është krijimi i një Programi Kombëtar që nxit 1) sportin masiv, 2) zbulimin e talenteve, 3) edukatën sportive dhe parimet olimpike. Projekti do të formojë Ekipet sportive jashtë shkollore në nivelin 9-vjecar (nga klasa e 6 – 9); në nivelin shkollë e mesme (nga klasa 10 – 12); në universitete.

#### **Detyrat e Gazetarit/es**

Jemi në kërkim të një gazetari të kualifikuar për t'iu bashkuar stafit të projektit “Ekipet Sportive 2022”. Përpos të qenit një gazetar shumë i mirë, aplikanti i suksesshëm duhet të demonstrojë interesin e tij/saj për gazetarinë sportive, aftësi për të shkruar artikuj sportivë, për të zhvilluar intervista sportive, për të komentuar evente sportive etj. Objektivi kryesor i pozicionit të gazetarit do të jetë krijimi dhe raportimi i lajmeve dhe transmetimeve të aktiviteteve të projektit. Gazetari/ja do të përfshihet në cdo detyre të nevojshme për ecurinë normale të punës apo të caktuar nga supervizori. Puna e gazetarit është parashikuar si në terren, po ashtu dhe në studio. Duhet të jeni miqësor, të vetë-motivuar dhe të keni aftësi të jashtëzakonshme komunikimi me shkrim dhe verbal.



# Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

## Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63  
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: [secretariat@nocalbania.org.al](mailto:secretariat@nocalbania.org.al) • <http://www.nocalbania.org.al>

Për të përmbushur objektivat e caktuara Gazetari/ja duhet të ketë:

### Kualifikimet dhe Eksperienca:

- Të ketë minimumi një diplomë Bachelor në Gazetari dhe Shkenca Komunikimi.
- Eksperiencë pune minimum 5 vjet.
- Të ketë experiencë të mëparshme si gazetar/e terreni.
- Preferohet të ketë punuar në 3 vitet e fundit në mediat sportive.
- Të ketë njohuri shume të mira të gjuhës Angleze.

### Aftësi dhe kompetenca kryesore

- Aftësi ndërpersonale, komunikim profesional verbal dhe të shkruar.
- Të ketë aftësi për të bërë lidhje dhe transmetim të lajmit live.
- Aftësi shumë të mira të folurit në publik dhe live në transmetime televizive.
- Aftësi bashkëpunimi dhe ndërveprimi në ekip dhe me drejtuesit.
- Qasje pozitive dhe energjike në punë.
- Orientim ndaj detajeve dhe organizimit të proceseve të punës.

### Procedura e aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentat e aplikimit si më poshtë:

- Curriculum vitae (CV) në formatin Europass;
- Letër Interesi;
- Fotokopje të diplomave universitare;
- Dokumente të tjera mbështetëse (çertifikata të fituara nga trajnime, pjesëmarrje në konferenca, botime, letra reference, etj).

Kandidatët e interesuar duhet t'i dërgojnë dokumentet e aplikimit deri më datë 04 Maj 2022, ora 16.00, në adresën [secretary.general@nocalbania.org.al](mailto:secretary.general@nocalbania.org.al), me subjekt: **Aplikim për pozicionin Gazetar/e "Ekipet Sportive 2022"**